

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“ PËR PËRCAKTIMIN E PERIUDHËS SË SHFRYTËZIMIT DHE NIVELIN MINIMAL TË KAPACITETIT TË SHFRYTËZIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”, ka si qëllim përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit për strukturat akomoduese si dhe procedurat e deklarimit të tyre, sipas parashikimeve të nenit 64/1, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

Ky projektvendim përcakton:

- periudhën e shfrytëzimit, e cila përfshin të gjithë vitin kalendarik, por i ndarë në dy periudha sezonale, konkretisht në periudhat 1 maj deri në 30 shtator dhe 1 tetor deri në 30 prill;
- nivelin minimal të shfrytëzimit të strukturave akomoduese, i cili parashikohet të jetë 65% e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën e shfrytëzimit 1 maj deri në 30 shtator, dhe 30% e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën e shfrytëzimit 1 tetor deri në 30 prill; si dhe
- saktëson procedurat për deklarimin e kapacitetit të shfrytëzimit nga strukturat akomoduese.

Projektvendimi synon të luftojë informalitetin në fushën e turizmit, duke nxitur strukturat akomoduese të deklarojnë të dhëna të sakta pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, të nivelit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese dhe numrit të saktë të turistëve që vizitojnë strukturat e tyre përgjatë periudhës së përcaktuar. Ky sistem deklarimi sjell një pasqyrim më të saktë përse i përket turistëve të akomoduar në strukturat akomoduese gjatë gjithë vitit, në të gjithë Shqipërinë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektakti nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2024.

Relacion mbi Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sektori i turizmit në Shqipëri konsiderohet si një sektor strategjik dhe prioritar për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim, nxitje të bizneseve të vogla e të mëdha, më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë.

Bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT, mbi numrin e shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri në muajt qershor, korrik, gusht dhe shtator përgjatë viteve 2021-2023, krahasuar me numrin e netëqëndrimeve të llogaritura nga deklarimi i strukturave akomoduese, rezulton se kemi një mospërputhje të konsiderueshme në shifra, të cilat tregojnë një nivel të lartë informaliteti në lidhje me këtë deklaram.

Të dhënat krahasuese paraqiten sipas tabelave më poshtë:

Numri i netë qëndrimeve të personave jo resident të deklaruar nga strukturat akomoduese (INSTAT)				
Muaji	Viti			
	2021	2022	2023	2024
Viti Janar	23,147	51,923	55,965	94,765
Shkurt	26,400	52,249	58,946	108,228
Mars	27,160	61,205	88,665	145,716
Prill	45,870	79,025	154,020	277,753
Maj	78,219	183,920	261,369	384,487
Qershor	196,952	304,345	489,107	662,924
Korrik	475,145	546,313	777,320	942,930
Gusht	672,779	651,445	1,014,164	
Shtator	248,230	307,159	557,001	
Tetor	94,853	120,930	196,057	
Nëntor	79,975	73,378	144,932	
Dhjetor	62,157	60,260	109,049	
Totali	2,030,887	2,492,152	3,906,595	2,616,803


Numri vizitorëve të huaj (INSTAT)				
Muaji	Viti			
	2021	2022	2023	2024
Janar	185,392	194,237	377,211	489,599
Shkurt	158,173	200,997	309,325	480,539
Mars	170,279	275,976	384,028	564,975
Prill	241,015	402,051	614,256	794,129
Maj	328,742	604,430	705,079	973,688
Qershor	604,381	876,056	1,007,033	1,244,967

Relacion mbi Projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese"

Korrik	1,158,962	1,403,333	1,770,724	1,818,378
Gusht	1,537,191	1,710,041	2,022,754	2,167,665
Shtator	494,332	761,544	1,104,190	-
Tetor	298,712	365,237	696,825	
Nëntor	244,061	358,350	547,221	
Dhjetor	267,409	391,565	616,994	
Totali	5,688,649	7,543,817	10,155,640	8,533,940


Në vitin 2023, Shqipërinë e vizituan 10,155,640 turistë të huaj. Netëqëndrime në struktura akomoduese gjithsej janë llogaritur 3,906,595, pra rreth 38% e numrit të turistëve. Duke llogaritur që turistët kanë qëndruar më shumë së një natë në Shqipëri, si dhe duke marrë parasysh faktin që një pjesë e tyre është akomoduar në miq dhe të afërm apo në struktura të vogla apartamente ose të ngjashme të paregjistruara, përsëri konstatohet një nivel tepër i lartë informaliteti në deklarime.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet numri total i vizitorëve të huaj për vitin 2023, i ndarë sipas secilës periudhë shfrytëzimi, ku rezulton se rreth 65% e vizitorëve të huaj kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë nga 1 maj deri më 30 Shtator, dhe vetëm 35% e tyre kanë hyrë në periudhën 1 tetor deri më 30 prill.



Në të njëjtën linjë mesa më lart, nga totali i numrit të netëve të qëndrimit për vitin 2023, rezulton se 79% e numrit të netëve të qëndrimit të personave jo resident të deklaruar nga strukurat akomoduese është gjatë periudhës 1 maj deri më 30 shtator, dhe vetëm 21% e tyre në periudhën 1 tetor deri më 30 prill.

Numri i netë qëndrimeve të personave jo resident të deklaruar nga strukturat akomoduese sipas periudhave të shfrytëzimit (viti 2023)



■ maj - shtator ■ tetor-prill

Krahasuar me vendet bregdetare të rajonit, bazuar në të dhënat e Eurostat për periudhën shtator 2023 – korrik 2024 (gusht 2024 nuk ka akoma të dhëna), Shqipëria rezulton se ka një nivel shfrytëzimi të strukturave akomoduese ndjeshëm më të ulët krahasuar me vendet e rajonit. Të dhënat pasqyrohen në tabelën në vijim.

Niveli i shfrytëzimit të strukturave akomoduese		
Periudha	Tetor 2023 – Prill 2024	Maj 2024, Korrik 2024 dhe Shtator 2023
Greqi	23%	67%
Kroaci	32%	72%
Mali i Zi	27%	60%
Shqipëri	17%	39%

Referuar të dhënave të mësipërme, bazuar dhe në të dhënat e vendeve bregdetare të rajonit, u përcaktua ndarja në dy periudha sezonale për përcaktimin e nivelit minimal të shfrytëzimit të strukturës akomoduese si dhe përqindjet e nivelit minimal të shfrytëzimit, sipas tabelës së mëposhtme.

Periudha e shfrytëzimit	Niveli minimal i shfrytëzimit të strukturës akomoduese
I maj deri më 30 shtator	65% e kapacitetit të strukturës akomoduese
I tetor deri më 30 prill	30% e kapacitetit të strukturës akomoduese

Ndërkohë, kemi edhe nivelin e taksës së fjetjes në hotele, të ardhurat nga e cila paraqiten në tabelën e mëposhtme. Ajo që vihet re nga kjo taksë, është fakti se niveli i mbledhjes së saj është ndjeshëm më i ulët nëse do të merrnim në konsideratë faktin se kanë qenë rreth 10 milion turistë të huaj dhe se kjo taksë është e deklaruar si për turistët e huaj ashtu dhe për ata vendas.

	Taksa e fjetjes në hotel shifrat në 000/lekë	

Relacion mbi Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”

Njësitë e vetqeverisjes vendore	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Taksa e fjetjes në % të totalit të taksës së mbledhur sipas zonave
Bashkia Durrës	18,796	24,914	65,391	16%
Bashkia Himarë	6,526	8,908	10,024	2%
Bashkia Kavaja	7,852	30,074	29,832	7%
Bashkia Lezhë	9,663	10,810	27,370	7%
Bashkia Sarandë	18,184	18,456	37,132	9%
Bashkia Shkodër	12,967	18,408	26,609	7%
Bashkia Tiranë	67,426	121,280	143,008	35%
Bashkia Vlorë	14,915	19,033	22,887	6%
Bashkitë e tjera	30,085	38,587	46,025	11%
TOTALI	186,414	290,470	408,278	100%

Kjo diferencë e madhe në shifra përgjatë 3 viteve të fundit, e ardhur nga mungesa e deklarimit apo deklarimet e pasakta nga strukturat akomoduese, kanë sjellë një tablo të pasaktë të të dhënave statistikore në lidhje me numrin e vizitorëve, duke shkaktuar mungesë të të ardhurave në buxhetin e shtetit. Për këtë arsye, lindi nevoja e rregullimit ligjor nëpërmjet këtij projektakti.

Projektvendimi synon përmirësimin e procedurës së deklarimit të nivelit të shfrytëzimit për strukturat akomoduese të kategorive: “Bujtinë”, “Bllok Apartamentesh”, “Motel”, “Fjetje dhe mëngjes”, “Hotel”, “Hotel i shpërndarë”, “Resort”, “Strukturë Akomoduese e Trashëgimisë Kulturore”.

Në vijim, vlerësohet se realizimi i qëllimit të këtij projektvendimi, do të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm midis strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit, njesive të vetqeverisjes vendore dhe Administratës Tatimore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe të pikës 7, të nenit 64/1, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, *i ndryshuar*.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim me Acquis Communautaire të BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Relacion mbi Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”

Projektvendimi përbëhet nga 12 pika, me përmbajtje si vijon:

Në **pikën 1**, shpjegohet objekti i këtij projektvendimi i cili synon përcaktimin e rregullave për shfrytëzimin e strukturave akomoduese dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të tyre, në funksion të deklarimit për qëllime tatimore, gjatë vitit buxhetor..

Në **pikën 2**, parashikohen përkufizimet mbi kapacitetin e strukturës akomoduese, kapacitetin e shfrytëzimit, dhe nivelin minimal të shfrytëzimit të kapacitetit.

Në **pikën 3**, parashikohen kategoritë e strukturave akomoduese të cilat janë objekt i këtij vendimi ku përfshihet: Bujtina, Bllok Apartamentesh, Motel, Fjetje dhe mëngjes, Hotel, Hotel i shpërndarë, Resort, si dhe Strukturë Akomoduese e Trashëgimisë Kulturore.

Në **pikën 4**, përcaktohet periudha e shfrytëzimit të strukturave akomoduese, e cila ndahet në dy periudha sezonale, përkatësisht 1 Maj deri në 30 shtator dhe 1 tetor deri 30 prill të çdo viti.

Në **pikën 5**, parashikohet procedura për llogaritjen e nivelit të shfrytëzimit të strukturës akomoduese. Ky nivel llogaritet duke marrë në konsideratë numrin e përgjithshëm të dhomave të shfrytëzuara përgjatë periudhës së shfrytëzimit në raport me kapacitetin e plotë të strukturës akomoduese gjatë kësaj periudhe. Për llogaritja e kapacitetit dhe nivelit minimal të shfrytëzimit paraqitet në mënyrë më të detajuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Në **pikën 6**, parashikohet niveli minimal i shfrytëzimit të strukturës akomoduese për periudhën shfrytëzimit të përcaktuar në pikën 5. Niveli minimal i shfrytëzimit të strukturës akomoduese parashikohet jo më pak se 65% e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën 1 Maj deri në 30 shtator dhe jo më pak se 30% e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën 1 tetor deri 30 prill. Kjo vlerë llogaritet si mesatare e nivelit minimal të shfrytëzimit përgjatë periudhës së shfrytëzimit.

Në **pikën 7**, parashikohet se sipërmarrësi turistik mund të zgjedhë të deklarojë nivelin e shfrytëzimit ose sipas nivelit minimal në pikën 6, ose sipas nivelit të shfrytëzimit që sipërmarrësi pretendon. Në rast të deklarimit sipas pretendimeve të sipërmarrësit, bazuar në dispozitat e ligjit 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, administrata tatimore nëpërmjet strukturave të saj, verifikon respektimin e deklarimit të kapaciteve të shfrytëzuara dhe në rastet kur këto kapacitete të shfrytëzuara, janë të pasakta dhe joreale atëherë administrata tatimore zbaton metodat alternative të vlerësimit për përcaktimin e detyrimeve tatimore sipas legjislacionit përkatës.

Në **pikën 8**, parashikohet se sipërmarrësi i strukturave akomoduese duhet të deklarojë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kapacitetin e shfrytëzimit brenda datës 30 mars 2025 dhe muajt Maj të vitit pasardhës, në rast se kanë ndryshime të kapacitetit të

Relacion mbi Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe nivelin minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”

strukturës akomoduese, si dhe nivelin e shfrytëzimit të strukturës akomoduese brenda datës 30 tetor të çdo viti për periudhën 1 maj deri në 30 shtator dhe brenda datës 31 maj për periudhën 1 tetor deri 30 prill.

Në pikën 9, përcaktohet se deklarimi do të bëhet sipas formatit në Aneksin 2, bashkëlidhur këtij projektvendimi .

Në pikën 10, parashikohet detyrimi i Ministrisë përgjegjëse për turizmin, që brenda muajit dhjetor të çdo viti t'i dërgojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Bashkisë që administrojnë territorin ku ndodhet struktura akomoduese të dhënat e deklaruara nga subjekti.

Në pikën 11, parashikohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektvendimi nuk parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI I TURIZMIT DHE

MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ